



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 3, datë 29.12.2016

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA BERAT

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 58 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 671, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Bashkisë Berat, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 108, datë 25.11.2016, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Berat.
2. Plani i Përgjithshëm Vendor përbëhet nga dokumentet si vijon:
 - a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
 - b) Plani i Zhvillimit të Territorit, shoqëruar me Shtojcën I, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit;
 - c) Rregullorja e Planit;
 - d) Materiali hartografik:
 - i. Vizioni strategjik;
 - ii. Ndarja e territorit në 5 sisteme;
 - iii. Ndarja e territorit në njësi;
 - iv. Përdorimi i propozuar i tokës sipas 14 kategorive bazë;
 - v. Infrastruktura e transportit;
 - vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.
3. Autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara për Zonat me Rëndësi Kombëtare është Këshilli Kombëtar i Territorit, me propozim të Ministrit përgjegjës.
4. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, Bashkia Berat duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor.

5. Ngarkohet Bashkia Berat për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen dokumentet e planifikimit / studimet urbanistike të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të bashkisë Berat, përfshirë si më poshtë:
 - Vendim Nr. 3, datë 04.04.2002 i KRRTRSH-së “Për zgjerimin e vijës kufizuese të qytetit të Beratit në zonën e ish-“pjeshkores” me sipërfaqe 72 ha, si dhe studimin urbanistik pjesor të kësaj zone.”;
 - Vendim Nr. 5, datë 19.02.2003 i KRRTRSH-së “Për detyrën e projektimit për studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Beratit dhe vijën kufizuese të kësaj qendre”;
 - Vendim Nr. 1, datë 15.06.2005 i KRRTRSH-së, “Për miratimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Beratit.”;
 - Vendim Nr. 3, datë 18.04.2008 i KRRTRSH-së, “Për miratimin e detyrës së projektimit për planin e përgjithshëm rregullues për qytetin e Beratit”;
 - Vendim Nr. 7, datë 20.12.2012 i KKT-së, “Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Berat”.
7. Planet e detajuara vendore dhe lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.
8. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

